**VENDIM**
**Nr. 39, datë 18.7.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i | Gjykatës | Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i | “ | “ |
| Petrit Plloçi | Anëtar | i | “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e | “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha, | Anëtar | i | “ | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datat 1.3.2012, 21.3.2012 dhe 10.4.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 3 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ermioni Fidhi, Katerina Fidhi, Fdhigalini Fidhi përfaqësuar nga avokat Abas Brati, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Dallëndyshe Hoxha, e përfaqësuar nga avokat Thimjo Kondi, me prokurë të posaçme.

Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

***Rrethanat e çështjes***

1. Mbështetur në vendimin objekt kërkese dhe në dosjen gjyqësore, rezulton se kërkuesit janë trashëgimtarë ligjorë të Zoto Fidhi. Ky i fundit, së bashku me Spiro Mosko, është njohur pronar dhe i është kthyer pronësia mbi një ndërtesë në qytetin e Gjirokastrës nga vendimi nr. 125, datë 28.5.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Gjirokastër (këtu e tutje referuar si vendimi 125), si dhe mbi një truall, në po këtë qytet, nga vendimi nr. 125/1, datë 17.3.1995 i po këtij Komisioni (këtu e tutje referuar si vendimi 125/1).

2. Ndërkohë, ndërtesa objekt e vendimit 125 ishte privatizuar nga subjekti i interesuar me vendim të Bordit të Privatizimit Gjirokastër nr. 5, datë 8.12.1993, finalizuar me kontratën noteriale datë 2.8.1994. Ndërsa truallin nën këtë ndërtesë, truall që është objekt i vendimit nr. 125/1 subjekti i interesuar e ka blerë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, me anë të kontratës nr. 2000 Rep., datë 8.3.1996.

3. Ndodhur në kushtet kur për objektet e sipërpërmendura ekzistonin akte që krijonin të drejta pronësie në favor të saj dhe të personave të tjerë, subjekti i interesuar i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me objekt “*Anulimin e vendimit nr. 125, datë 28.5.1994 dhe 125/1, datë 17.3.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”* me palë të paditur trashëgimtarin e Spiro Mosko dhe degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Kërkuesit, si trashëgimtarë të Zoto Fidhi, nuk

rezultojnë të jenë njoftuar për këtë gjykim apo të jenë thirrur të merrnin pjesë në të.

4. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, trashëgimtari i Spiro Mosko ngriti një kundërpadi me objekt *"Lirim dhe dorëzim i truallit dhe objektit të blerë nga paditësja"*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 92, datë 9.2.1999, vendosi rrëzimin e kundërpadisë dhe pranimin e pjesshëm të padisë. Kjo gjykatë la në fuqi kontratat e sipërpërmendura të shitblerjes të viteve 1994 dhe 1996, anuloi plotësisht vendimin nr. 125 dhe anuloi vetëm atë pjesë të vendimit nr. 125/1, që i takon sipërfaqes së truallit që është në pronësi të subjektit të interesuar, ndërsa urdhëroi që ish-pronarit kjo pjesë t'i njihet dhe t'i kompensohet. Ky vendim mori formë të prerë pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe nga Gjykata e Lartë, të cilat u vunë në lëvizje nga trashëgimtari i Spiro Mosko.

5. Në vitin 2006, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuesit njihen si trashëgimtarë ligjorë të Zoto Fidhi, i cili ka vdekur në vitin 1954.

6. Me cilësinë e trashëgimtarit, kërkuesit i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me padi me objekt *"Kërkimin e trashëgimit, njohjen si trashëgimtar mbi truallin e përfituar nga veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm, kontrata e shitblerjes së truallit me nr. 2000 Rep. dhe nr. 336 Kol. të datës 8 mars 1996 të hartuar nga noterja G. K., duke e liruar dhe dorëzuar atë"*. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 2146, datë 5.12.2008 vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

7. Kundër këtij vendimi kërkuesit ushtruan të drejtën e ankimit përpara Gjykatës së Apelit Gjirokastër, e cila, me vendimin nr. 111, datë 18.3.2009, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 2146, datë 5.12.2008.

8. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër kërkuesit ushtruan të drejtën e rekursit përpara Gjykatës së Lartë, e cila, me vendimin nr. 00-2011-1238 (353) datë 5.7.2011, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 111 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në mënyrë të përmbledhur, vendimin e saj Gjykata e Lartë e mbështeti në dy arsyetime: së pari, padia e kërkimit të trashëgimit mund të ngrihet vetëm ndaj dikujt që posedon trashëgiminë, sepse *"pretendon se është trashëgimtar ligjor ose testamentar i trashëgimlënësit (pra të gëzojë këtë cilësi)"* (f. 8 e vendimit). Rrjedhimisht pala e paditur nuk gëzonte legjitimitetin pasiv. Së dyti, edhe pse vendimi i formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, nuk përbën gjë të gjykuar për kërkuesit, pasi ata nuk ishin palë në atë gjykim, gjykatat nuk mund të mbajnë një qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në të përderisa është kërkuar e njëjta gjë e mbështetur mbi të njëjtat prova (f. 12 e vendimit objekt kërkese).

II

***Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese***

9. ***Kërkuesit*** pretendojnë se vendimi nr. 00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (vendimi objekt kërkese) u ka cenuar të drejtën themelore të pronës nëpërmjet zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, duke arsyetuar se:

9.1 *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë*. Gjykata e Lartë duke keqinterpretuar nenin 349 të Kodit Civil nuk i ka njohur legjitimitetin pasiv subjektit të interesuar që ka qenë në pozitën e palës së paditur. Për pasojë, ky vlerësim ka sjellë rrëzimin e rekursit, pa u gjykuar nga Gjykata e Lartë thelbi i pretendimeve.

9.2 Është *shkelur parimi i kontradiktoritetit*. Gjykata e Lartë, duke arsyetuar se vendimi i formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër edhe pse nuk përbën gjë të gjykuar i shtrin efektet edhe ndaj kërkuesve që nuk janë as palë, as trashëgimtarë të palëve në atë gjykim dhe as persona që tërheqin të drejta në atë gjykim, ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur para se të gjykohesh.

9.3 *Është cenuar standardi kushtetues, sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, logjike dhe jokontradiktore*.

10. ***Subjekti i interesuar*** gjatë gjykimit parashtroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

10.1 Nuk është cenuar e drejta e kërkuesve për akses, pasi Gjykata e Lartë ka interpretuar drejt dhe saktë nenet 349-352 të Kodit Civil. Gjykatat nuk kanë legjitimuar kërkuesit për paraqitjen e padisë së kërkimit të trashëgimit, por i kanë legjitimuar ato për pretendimin e konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit.

10.2 Nuk është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe mbrojtur para se të gjykohesh, pasi vetë Gjykata e Lartë e pranon se nuk ndodhet përpara gjësë së gjykuar për shkak të mungesës së elementit subjektiv. Gjykata e Lartë i ka dëgjuar konform të gjitha rregullave procedurale pretendimet e kërkuesve. Gjykata e Lartë i ka administruar të gjitha provat që janë paraqitur nga kërkuesit. Meqenëse Gjykatës së Lartë i shtrohej i njëjti

pretendim, me të njëjtin kuadër ligjor, ajo e kishte të pamundur të arrinte në një përfundim juridik të ndryshëm nga ai i arritur në gjykim të mëparshëm.

III

***Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese***

***1. Mbi pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit) për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë.***

11. Në shqyrtimin e këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson të nevojshme të përsërisë qëndrimin e saj konstant se, në kuadër të kontrollit që ajo ushtron në zbatim të nenit 131/f të Kushtetutës, çështjet e interpretimit të ligjit hyjnë në juridiksionin kushtetues vetëm nëse dhe për aq sa ky interpretim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

12. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në përputhje me standardin e mësipërm, Gjykata duhet të vlerësojë interpretimin e nenit 349 të Kodit Civil të bërë nga Gjykata e Lartë vetëm për aq sa ky interpretim cenon të drejtën e aksesit të kërkuesve.

14. Gjykata ka konsoliduar tashmë praktikën e saj në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). Gjykata ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se *"Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor"* (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 4, datë 23.2.2011).

15. E drejta e aksesit në gjykatë mund t'i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 8.7.2009)*. Megjithatë, e drejta e aksesit nuk konsiderohet e mohuar apo e kufizuar nëse vetë sjellja apo veprimet e subjektit janë në origjinë të mohimit apo kufizimit.

16. Gjykata Kushtetuese vëren, në vijim të standardeve paraqitur më sipër, se Gjykata e Lartë, edhe pse ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesit, sipas tyre, nuk ka shqyrtuar disa pretendime të parashtruara në të. Gjykata e Lartë, duke interpretuar nenin 349 të Kodit Civil, vlerësoi se kërkuesit kishin ngritur padinë e papërshtatshme për të kërkuar posedimin e sendit dhe, për pasojë, pretendimet që kishin të bënin me ligjshmërinë e titullit të pronësisë së subjektit të interesuar nuk mund të shqyrtoheshin për mungesë të legjitimitetit pasiv.

17. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është para së gjithash detyrë e organeve që e zbatojnë atë. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim në përputhje të plotë me interpretimin konstant që ajo i bën ndër vite nenit 349 të Kodit Civil. Vendimi objekt kërkese rezulton se është në koherencë me vendimin nr. 19, datë 15.3.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1743, datë 28.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 1267, datë 26.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 00-2007-1553 të vendimit (1254), datë 6.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë

31.5.2011. Në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre.

18. Në këtë kuadër, Gjykata Kushtetuese vëren se Gjykata e Lartë ka vlerësuar në vendimin objekt kërkese (f. 8 dhe 9) se kërkuesit kishin në dispozicion padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 të Kodit Civil. Kjo padi mund të ngrihet nga çdo subjekt që pretendon se është pronar i një sendi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Në vijim të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 31.5.2011, kjo padi është e paparashkrueshme dhe për këtë arsye mund të ushtrohet në çdo kohë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi objekt kërkese nuk cenon të drejtën e aksesit të kërkuesve, pasi në përputhje me qëndrimin e Gjykatës së Lartë, ata mund të ushtrojnë në çdo kohë padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil për të mbrojtur të drejtat e tyre.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesve. Gjykata vlerëson se mosshqyrtimi i disa pretendimeve të ngritura në rekurs e ka origjinën te vetë sjellja e kërkuesve, të cilët nuk kanë ushtruar padinë e përshtatshme për mbrojtjen e pronësisë së tyre.

20. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi se është cenuar e drejta e aksesit për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, është i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të pranohet.

***2. Mbi pretendimin e cenimit të parimit të kontradiktoritetit.***

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre.

22. Edhe pse parimi i kontradiktoritetit mund të zhvillohet më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ku ky i fundit është pjesë e të drejtës së mbrojtjes të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, është përsëri i zbatueshëm në procesin civil, pasi edhe ky proces duhet të garantojë barazi substanciale të palëve.

23. Në këtë aspekt, një rol të veçantë ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë (*shih Vermeulen k. Belgjikës, vendimi i datës 20 shkurt 1996 § 33; Nideröst-Huber k. Zvicrës, vendimi i datës 18 shkurt 1997, § 24*).

24. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese në procesin civil ka tashmë një praktikë të konsoliduar sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 25.7.2011*).

25. Gjykata, nga shqyrtimi i vendimit objekt kërkese e vlerëson të drejtë parashtrimin e subjektit të interesuar se ky parim nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, e cila i ka krijuar të gjitha mundësitë kërkuesve për të paraqitur pretendime dhe prova apo për të kundërshtuar ato të palës tjetër. Gjykata vëren se pikërisht në respektim të këtij parimi Gjykata e Lartë, në vendimin objekt kërkese, ka ndryshuar arsyetimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila konsideronte se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. 92, datë 9.2.1999 i shtrin efektet ndaj kërkuesve. Gjykata e Lartë nuk e konsideron vendimin nr. 92, të sipërpërmendur, sikur përbën gjë të gjykuar, por e konsideron si një provë, vlera e së cilës është përcaktuar nga ajo pasi i është nënshtruar debatit gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktoritetit.

26. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi se është cenuar parimi i kontradiktoritetit është i pabazuar.

***3. Mbi pretendimin e cenimit të standardit kushtetues sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.***

27. Kërkuesi pretendon përpara Gjykatës se vendimi objekt kërkese është jologjik dhe kontradiktor, pasi Gjykata e Lartë edhe pse shprehet se subjekti i interesuar nuk ka legjitimitetin pasiv, nga ana tjetër shprehet se ky subjekt e ka fituar pronësinë në mënyrë të ligjshme.

28. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. "E drejta është rregull, dhe e drejta e dhënë logjikisht është e drejtë shumë e mirë", ka thënë Aristoteli. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.

29. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 8.12.2005*).

30. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se analiza që i bëhet titullit të pronësisë të subjektit të interesuar i shërben vërtetimit të faktit që ky subjekt nuk e ka fituar pronësinë e tij me anë të trashëgimisë, por me anë aktesh ekzistenca dhe ligjshmëria e të cilave rezulton nga provat në dosje dhe veçanërisht nga vendimi i formës së prerë, nr. 92 të vitit 1999, i sipërpërmendur.

31. Ky fakt rezulton nga vendimi objekt kërkese në të cilin Gjykata e Lartë shprehet (f. 10) se "*Në kushtet që kjo lloj padie* (padia për kërkimin e trashëgimit) *nuk mund të ngrihet ndaj të paditurës Dallëndyshe Hoxha, pasi ajo nuk e ka fituar pronën që posedon sot as si trashëgimtare ligjore dhe as si trashëgimtare testamentare e trashëgimlënësit, ky kolegj* vlerëson se *nuk mund të kërkohet ndaj të paditurës as lirimi dhe dorëzimi i pronës, aq më tepër që kjo e fundit e ka fituar pronën në mënyrë të ligjshme. Fakti që ana e paditur, pronësinë mbi objektin dhe truallin e ka fituar në mënyrë të ligjshme është vërtetuar jo vetëm nga provat shkresore, të cilat ndodhen në dosje, por dhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nr. 92, datë 9.2.1999.*"

32. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kjo analizë është në mbështetje të arsyetimeve mbi të cilat është bazuar Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

33. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara dhe si të tilla nuk mund të pranohen.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo[1], Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi
Anëtarë kundër pjesërisht: Sokol Berberi

[1] Gjyqtari Vladimir Kristo votoi pro rrëzimit të kërkesës, por me arsyetim paralel.

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka rrëzuar pretendimet e kërkuesve Ermioni Fidhi, Katerina Fidhi dhe Fdhigalini Fidhi në lidhje me shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.00-2011-1238 (353), datë 5.7.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, për rrëzimin e kërkesës, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me arsyetimin e shumicës për sa i takon pretendimit të kërkuesve për cenimin e të drejtës së aksesit, sikurse jam shprehur dhe më parë (shih mendimin paralel të vendimit nr.26, datë 13.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

2. *Shumica, në thelb, ka çmuar se "... interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit të kërkuesve. Gjykata vlerëson se mosshqyrtimi i disa pretendimeve të ngritura në rekurs e ka origjinën te vetë sjellja e kërkuesve, të cilët nuk kanë ushtruar padinë e përshtatshme për mbrojtjen e pronësisë së tyre", duke arritur në këtë mënyrë në përfundimin se "pretendimi se është cenuar e drejta e aksesit për shkak të keqinterpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, është i pabazuar dhe si i tillë nuk mund të pranohet"*(shih § 19 dhe 20 të vendimit).

3. Bazuar në parimin *jura novit curia*, Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, mendoj se pavarësisht nga formulimi i kërkesës, pretendimet e mësipërme të kërkuesve duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të të drejtës së ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

4. E drejta e aksesit dhe e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, standarde këto të mbrojtura respektivisht nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës janë dy çështje me natyrë kushtetuese në thelb të ndryshme dhe me dallime të qarta nga njëra-tjetra.

5. Gjykata, sikurse argumenton dhe shumica, në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 42 të Kushtetutës, e drejta për akses në gjykatë të referon tek e drejta që ka çdo individ për t'u drejtuar në një gjykatë, që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 10, datë 29.3.2011; nr. 26, datë 13.6.2011; nr. 41, datë 28.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Sipas legjislacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit, të cilat janë të formës së prerë. Ndaj tyre, organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore kanë detyrimin për t'i venë menjëherë në zbatim.

7. Nisur nga sa më lart, në çështjen objekt gjykimi, kërkuesit kanë pasur akses të plotë në gjykatë në kuptimin kushtetues. Ata jo vetëm kanë realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare, përderisa ankimi i tyre jo vetëm është shqyrtuar dhe konsideruar nga gjykata e apelit, por kjo e fundit ka dalë dhe me një vendim përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Nga kjo pikëpamje, mendoj se nuk mund të shtrohet për diskutim cenimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila parashikon standardet minimale për mbrojtjen e këtyre të drejtave nga shtetet palë në të.

8. Çështja që u përket kërkuesve jo vetëm është dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në rastin konkret Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, por vendimi i marrë prej saj është ankimuar nga kërkuesit në Gjykatën e Apelit të Gjirokastrës, e cila ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë një vendim përfundimtar të formës së prerë. Me marrjen e këtij vendimi, kërkuesit kanë realizuar tërësisht të drejtën e aksesit dhe, për rrjedhojë, procesi i zhvilluar ndaj tyre ka qenë plotësisht i rregullt edhe në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

9. Kushtetutëbërësi shqiptar, duke sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, ka parashikuar një standard më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në raport me ato të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së. Mosrealizimi i kësaj të drejte nga cilido shtetas shqiptar nuk do të thotë aspak se atij i është mohuar e drejta për akses për sa kohë që ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor dhe është marrë një vendim nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj dhe,

për më tepër, ky vendim ka marrë formë të prerë në apel gjë që e bën atë përfundimtar. Në këto raste mund të pretendohet vetëm për cenim të së drejtës të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, në rastin konkret, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

10. Duke e shqyrtuar çështjen nga këndvështrimi i mësipërm, jam i mendimit se kërkuesit, pavarësisht se nuk e kanë pretenduar, kanë realizuar plotësisht edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, e cila jo vetëm ka pranuar rekursin e paraqitur prej tyre, por njëkohësisht e ka shqyrtuar atë në seancë gjyqësore.

11. Nga sa më lart, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën e kërkuesve për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Vladimir Kristo

## MENDIM PAKICE

Nuk mund të bashkohem me vendimin e shumicës së Gjykatës Kushtetuese për rrëzimin e kërkesës së kërkuesve Ermioni Fidhi etj., për arsyet si vijon:

1. Nga dosja gjyqësore rezulton se i quajturi Zoto Fidhi bën pjesë në rrethin e subjekteve që përfitonin nga zbatimi i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", si i shpronësuar. Me vendimin nr. 125, datë 28.5.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Gjirokastër, kërkuesve - trashëgimtarë të Zoto Fidhi, si dhe trashëgimtarëve të Spiro Mosko - u është njohur dhe kthyer pronësia mbi një godinë njëkatëshe në krah të Nënstacionit Elektrik, Gjirokastër.

Po ky Komision, me vendimin nr. 125/1, datë 17.3.1995, u ka kthyer pronësinë trashëgimtarëve të Zoto Fidhi (kërkuesve) dhe Spiro Mosko, mbi një sipërfaqe të lirë 3091 $m^2$, duke u njohur pronësinë njëkohësisht mbi dy sipërfaqe trualli prej 1029 $m^2$ dhe 180 $m^2$, mbi të cilën ngrihej dhe një godinë njëkatëshe. Rezulton, gjithashtu, se me kontratën e shitblerjes, datë 2.8.1993, subjekti i interesuar (pala e paditur në gjykimet e zakonshme) Dallëndyshe Hoxha ka blerë objektin e quajtur *"Reparti i Leshit dhe i Konfeksioneve"*, ndërsa truallin prej 180.4 $m^2$ e ka marrë me qira. Më pas, me kontratën e shitblerjes (privatizimit), datë 8.3.1996, e paditura (subjekti i interesuar) Dallëndyshe Hoxha ka blerë nga dega e AKP-së Gjirokastër edhe truallin prej 773 $m^2$, kthimi i të cilit ka qenë objekti i padisë së paditësve (kërkuesve).

2. Me vendimin nr. 2146, datë 5.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, është rrëzuar padia e paditësve (kërkuesve) me arsyetimin se të paditurës i mungon legjitimimi pasiv.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 111, datë 18.3.2009, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së rrethit, por me arsyetim tjetër, dhe konkretisht se çështja e paraqitur për gjykim përbën gjë të gjykuar në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile. Mbi rekursin e paditësve (kërkuesve) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 353, datë 5.7.2011, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, por me arsyetim tjetër, dhe konkretisht se të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv, në kuptim të nenit 349 të Kodit Civil.

3. Kërkuesit (paditësit në gjykimet e zakonshme) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si jokushtetues të vendimit të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se ky vendim *u cenon atyre të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

4. Sipas kërkuesve, *cenimi i aksesit* ka ardhur si rezultat i interpretimit të gabuar nga ana e Gjykatës së Lartë të nenit 349 të Kodit Civil, duke arsyetuar në vendimin e kundërshtuar se padia për kërkimin e trashëgimit mund të ngrihet vetëm ndaj personit që pretendon se posedon pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit dhe jo ndaj personit që e posedon pasurinë trashëgimore në një mënyrë tjetër.

Shumica e Gjykatës Kushtetuese e ka rrëzuar këtë pretendim të kërkuesve duke arsyetuar, në esencë, se *Gjykata e Lartë nuk i është futur shqyrtimit në themel të rekursit, sepse në interpretim të nenit 349 të Kodit Civil, ka vlerësuar se kërkuesit kishin ngritur padi të papërshtatshme për të kërkuar posedimin e sendit dhe, për pasojë, pretendimet që kishin të bënin me ligjshmërinë e titullit të pronësisë të subjektit të interesuar nuk mund të shqyrtoheshin për mungesë të legjitimitetit pasiv.* Shumica në vendim shton, gjithashtu, se *Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim në përputhje me interpretimin konstant që ajo i bën ndër vite nenit 349 të Kodit Civil, dhe se në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale*

*në dispozicion të tyre, siç është padia e rivendikimit.*

Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, mendoj se arsyetimi i shumicës është i gabuar. Vetëm fakti se interpretimi i nenit 349 në vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë është në përputhje me interpretimin e saj konstant për këtë nen, nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se ky interpretim është i drejtë.

Është e vërtetë se sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe jurisprudencës së krahasuar, Gjykatës Kushtetuese nuk i kërkohet të shqyrtojë konstatimin e fakteve apo interpretimin e ligjeve të zakonshme të bërë nga gjykatat e zakonshme, me kusht që vendimet e gjykatave të zakonshme të mos kenë shkelur të drejtat kushtetuese. I tillë është rasti kur në një vendim të gjykatës së zakonshme, të drejtat kushtetuese nuk janë respektuar apo janë aplikuar në mënyrë të gabuar, duke përfshirë rastet kur aplikimi i ligjit ka qenë haptazi/dukshëm arbitrar, ... apo kur të drejtat themelore procedurale janë shkelur (të drejtat për gjykim të drejtë/fair, akses në gjykatë, e drejta për mjete efektive, etj.). Një qëndrim të tillë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetues Gjermane. Kështu, kjo gjykatë në çështjen Mefisto, ndër të tjera, është shprehur se në *mënyrë të veçantë, "konstatimi dhe vlerësimi i fakteve dhe interpretimi dhe aplikimi i ligjeve, në çështjet që u janë paraqitur për shqyrtim, janë detyra të gjykatave të zakonshme dhe nuk mund të rishqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese Federale, dhe se Gjykata Kushtetuese e sheh funksionin e saj në përcaktimin nëse, gjykatat e zakonshme, në fakt, kanë peshuar në mënyrë adekuate të drejtat e palëve në konflikt, në bazë të Ligjit Bazë (Kushtetutës), nëse ato (gjykatat e zakonshme) u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese, që implikohen në çështje, dhe nëse vendimi i gjykatës së zakonshme demonstron ndonjë konceptim të pasaktë të esencës së të drejtës themelore – objekt shqyrtimi"*. Edhe Gjykata Kushtetuese e Bosnjë-Hercegovinës, pothuajse në të njëjtën linjë, është shprehur se Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë interpretimin e ligjeve të bërë nga gjykatat e zakonshme në rastet kur interpretimi dhe aplikimi i ligjit nga ana e tyre ka qenë haptazi i gabuar (*shih vendimin BIH-2002-2-002*).

Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të kërkuesve për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, duhet të ekzaminonte nëse interpretimi nga Gjykata e Lartë i nenit 349 të Kodit Civil ishte ose jo haptazi i gabuar.

Mendoj se interpretimi i këtij neni nga Gjykata e Lartë, për sa i përket çështjes se ndaj kujt mund të ngrihet padia e kërkimit të trashëgimit (legjitimimi pasiv), është haptazi i gabuar.

Sipas kësaj dispozite, *trashëgimtari mund të kërkojë me padi **nga kushdo** që posedon … pasurinë trashëgimore, njohjen e tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore…*

Në vendimin e kundërshtuar, Gjykata e Lartë është shprehur se *" ..ajo çka është parashikuar në nenin 349 të Kodit Civil … [është] një nga paditë me anën e së cilës mund të kërkohet pasuria trashëgimore; përdorimi i termit "nga kushdo që posedon …" nuk nënkupton çdo lloj personi apo subjekti, por nënkupton mbajtjen e pasurisë trashëgimore nga kushdo i cili pretendon se është trashëgimtar (pra, të gëzojë këtë cilësi) dhe në asnjë rast nuk nënkupton që i padituri të ketë fituar pronësinë mbi këtë pasuri në një mënyrë tjetër jashtë trashëgimisë."*

Sipas rregullave të interpretimit, ligjeve nuk mund t'u jepet tjetër kuptim veç atij që del qartazi nga kuptimi i vetë fjalëve duke marrë parasysh lidhjen e tyre, si dhe nga qëllimi i ligjvënësit (*shih nenin 2, paragrafi i parë i Kodit Civil të vitit 1929*).

Duke respektuar këto rregulla, edhe në rastin e interpretimit të nenit 349 të Kodit Civil, duke parë formulimin e këtij neni, del qartë se trashëgimi mund të kërkohet me padi nga kushdo. Në aspektin gjuhësor termi "kushdo" është një përemër i pakufishëm, i cili sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe ka kuptimin "çdo njeri", "gjithkush", "cilido", "secili". Kjo do të thotë se ky term përjashton çdo lloj kufizimi në personin ndaj të cilit mund të ngrihet padia që parashikon neni 349 i Kodit Civil. E vetmja cilësi që duhet të ketë personi ndaj të cilit duhet të kërkohet trashëgimi, është ajo e poseduesit, pavarësisht nëse ka ose jo titull, e aq më pak nga lloji i titullit të posedimit. Për pasojë, nuk mund të pranohet arsyetimi i Gjykatës së Lartë, se termi "kushdo" nënkupton vetëm ata që e mbajnë pasurinë si trashëgimtarë, duke përjashtuar mbajtësit me tituj të tjerë, përveç trashëgimisë, apo mbajtës pa ndonjë titull.

Prandaj, mendoj se për caktimin e personit kundër të cilit do të ngrihet padia për kërkimin e

trashëgimit, vendimtare është situata faktike e posedimit, pa bërë dallim nëse ky posedim ka ardhur si pasojë e ndonjë titulli apo është edhe pa titull, si dhe pa marrë parasysh llojin e titullit: posedimor, pronësor, apo mbajtës i thjeshtë. Pikërisht, duke qenë se e drejta e trashëgimisë është një e drejtë absolute, sipas nenit 349 të Kodit Civil, trashëgimi mund të kërkohet me padi nga kushdo. Për pasojë, edhe neni 350 i Kodit Civil parashikon se padia e kërkimit të trashëgimit mund të ngrihet edhe kundër një personi që e mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi. Në këtë rast, lidhësja "edhe" më shumë se përfshirëse e rastit të personit që e mban pasurinë trashëgimore në bazë të një dëshmie trashëgimi, nënkupton domosdoshmërinë e përfshirjes edhe të personave të tjerë që e mbajnë pasurinë trashëgimore jo në bazë të një dëshmie trashëgimie. Këtej del edhe qëllimi i ligjvënësit për t'i dhënë një mbrojtje të plotë të drejtës kushtetuese të pronësisë që buron nga trashëgimia, si një e drejtë absolute.

Edhe duke i bërë *një vështrim historik* Institutit të Kërkimit të Trashëgimit, konstatohet se ky institut ka pësuar ndryshime në raport me rregullimet që ka pasur sipas Dekretit për Trashëgiminë (neni 19) dhe sipas Kodit Civil të vitit 1981 (neni 101). Në të dyja këto rregullime, ky Institut ka pasur rregullim të njëjtë. Konkretisht, sipas nenit 19 të Dekretit për Trashëgiminë dhe nenit 101 të Kodit Civil të vitit 1981 *"..trashëgimtari ka të drejtë të ngrejë padi kundër* ***personit që mban pasurinë si trashëgimtar…*** *Padia mund të ngrihet edhe kundër personit që mban pasurinë në bazë të një dëshmie trashëgimie …"*. Në ndryshim, Kodi Civil i vitit 1994 ka parashikuar se *"trashëgimtari mund të kërkojë me padi* ***nga kushdo që posedon*** *… pasurinë trashëgimore…"*

Pra, siç shihet nga formulimi i neneve përkatëse të Dekretit për Trashëgiminë dhe Kodit Civil të vitit 1981, në mënyrë të shprehur, kërkimi i trashëgimit ishte kufizuar vetëm ndaj personit që e mbante pasurinë si trashëgimtar. Në ndryshim nga këto dy akte ligjore, Kodi Civil i vitit 1994 e zgjeroi rrethin e personave ndaj të cilëve mund të kërkohej trashëgimi, duke e hequr formulimin *kundër* ***personit që e mban pasurinë si trashëgimtar*** dhe duke e zëvendësuar këtë me formulimin **nga kushdo që posedon …** *pasurinë trashëgimore…*

Në këtë mënyrë, në qoftë se me Dekretin për Trashëgiminë dhe me Kodin Civil të vitit 1981, i padituri në padinë e trashëgimit mund të ishte vetëm personi që e mbante pasurinë si trashëgimtar, me Kodin Civil të vitit 1994, u zgjerua sfera e aksesit në gjykatë për kërkimin e trashëgimit, duke dhënë mundësi për kërkimin e tij jo vetëm ndaj personave që e mbajnë atë si trashëgimtar, por duke parashikuar kërkimin e trashëgimit nga kushdo posedues, pavarësisht se e ka me titull apo pa titull.

Interpretimi i mësipërm i bërë nga Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar, do të ishte i saktë vetëm në qoftë se rregullimi juridik i këtij Instituti, me Kodin Civil të vitit 1994, nuk do të kishte ndryshuar. Mirëpo me këtë Kod, ligjvënësi qëllimisht, në harmoni edhe me karakterin absolut të së drejtës së pronësisë private që fitohet me trashëgimi (nenit 41 i Kushtetutës së RSH-së), e zgjeroi rrethin e personave ndaj të cilëve mund të kërkohet trashëgimi, duke siguruar kështu një mbrojtje të plotë të kësaj të drejte kushtetuese.

Konkluzionet e mësipërme mbështeten edhe nga një vështrim krahasues i rregullimit të këtij instituti në kodet homologe, italian dhe francez, nga të cilët është frymëzuar edhe Kodi Civil shqiptar. Kështu, mund të konstatoj se në këto kode, rregullimi i Institutit të Kërkimit të Trashëgimit është pothuajse i ngjashëm me atë të Kodit Civil aktual të RSH-së. Konkretisht, sipas nenit 730-4 të Kodit Civil francez *trashëgimtarëve … u njihet e drejta* ***ndaj personave të tretë që janë mbajtës të pasurisë trashëgimore***, *të disponojnë lirisht këtë pasuri …* Edhe sipas nenit 533/1 të Kodit Civil italian *trashëgimtari mund të kërkojë njohjen e cilësisë së tij si trashëgimtar* ***ndaj kujtdo që posedon … pasurinë trashëgimore*** *në titullin e trashëgimtarit ose pa titull, me qëllim që të arrijë kthimin e kësaj pasurie*. Duke komentuar këtë dispozitë të Kodit Civil italian, e cila i korrespondon nenit 349 të Kodit Civil shqiptar, autori italian Fancesco Galgano, shprehet *se trashëgimtarit ligjor, që ka pranuar trashëgiminë i është njohur kundër poseduesit të të mirave materiale trashëgimore, një padi e veçantë: padia e trashëgimisë. Kjo padi ndryshon nga padia e rivendikimit, sepse nuk bazohet mbi provën e të drejtës së pronësisë, por mbi atë të cilësisë së trashëgimtarit.* Kështu, vetëm një dallim vëren autori italian midis padisë për kërkimin e trashëgimit dhe padisë së rivendikimit. Kjo do thotë se edhe nga pikëpamja e subjekteve ndaj të cilëve mund të ngrihet padia e kërkimit të trashëgimit, kjo nuk ka asnjë dallim nga padia e rivendikimit dhe, për pasojë, edhe kjo padi mund të ngrihet ndaj kujtdo mbajtësi të pasurisë trashëgimore, e jo vetëm ndaj personit që pretendon se e posedon pasurinë trashëgimore me cilësinë e trashëgimtarit.

Pra, edhe nga vështrimi krahasues i Kodit Civil shqiptar të vitit 1994 me Kodin Civil italian dhe atë francez, rezulton se në të tria këto kode, trashëgimi mund të kërkohet *nga kushdo*, e jo vetëm nga ai i cili pretendon se është trashëgimtar.

Mendoj se Gjykata e Lartë ka gabuar, sepse nuk ka vënë re ndryshimin në formulimin e neneve përkatëse të Dekretit për Trashëgiminë dhe Kodit Civil të vitit 1981 me nenin 349 të Kodit Civil të vitit 1994. Duke mos vënë re këtë ndryshim në formulim, Gjykata e Lartë në vendimin e saj të kundërshtuar, lidhur me legjitimin pasiv në padinë e kërkimit të trashëgimit, është mbështetur në jurisprudencën dhe doktrinën juridike që ekzistonte para miratimit të Kodit Civil të vitit 1994. Mirëpo me ndryshimin e formulimit normativ, edhe jurisprudenca, edhe doktrina duhet të pësojë ndryshime sipas rregullit që jurisprudenca dhe doktrina juridike ndjekin ndryshimet normative. Në fakt, siç u tha më sipër, megjithëse neni 349 i Kodit Civil të vitit 1994 lidhur me legjitimimin pasiv, ka ndryshuar, Gjykata e Lartë nuk e vë re këtë dhe në vendimin e saj vazhdon të mbështetet në jurisprudencën dhe doktrinën e para vitit 1994, duke ngushtuar kështu në mënyrë jokushtetuese sferën e subjekteve kundër të cilëve mund të ngrihet padia e kërkimit të trashëgimit.

Për sa më sipër, mendoj se Gjykata e Lartë, duke bërë një interpretim haptazi të gabuar, ka ngushtuar sferën e aksesit në gjykatë të kërkuesve, gjë që u shkel atyre të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës).

5. Lidhur *me cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pala kërkuese arsyeton, se cenimi i kësaj të drejte rezulton nga arsyeja e dytë e dhënë nga vendimi i kundërshtuar. Konkretisht, sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë, padrejtësisht, ka shtrirë efektet detyruese të vendimit të formës së prerë nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, edhe ndaj kërkuesve, të cilët nuk kanë qenë palë në këtë gjykim, si dhe nuk janë as trashëgimtarë dhe as persona që tërheqin të drejta nga palët e këtij vendimi.

Mirëpo, në kushtet kur lidhur me pretendimin e parë shpreha opinionin se Gjykata e Lartë u ka cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në gjykatë, vlerësoj se nuk është nevoja të shqyrtohet pretendimi tjetër për cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sepse këto të drejtat e fundit nuk mund të realizohen pa garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

Megjithatë, çështjen *e shtrirjes së efekteve detyruese të vendimit të formës së prerë* nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër edhe ndaj kërkuesve, mendoj ta shqyrtoj lidhur me arsyetimin tjetër të Gjykatës së Lartë se *në vlerësimin nëse ky interpretim konstant i nenit 349 të Kodit Civil nga Gjykata e Lartë i mohon kërkuesve të drejtën e aksesit, Gjykata Kushtetuese mban parasysh ekzistencën e mjeteve të tjera procedurale në dispozicion të tyre, siç është padia e rivendikimit*.

Pra, sipas vendimit të shumicës së Gjykatës Kushtetuese, një nga arsyet pse kërkuesve nuk u është cenuar aksesi në gjykatë nga vendimi i Gjykatës së Lartë, është se kërkuesit kanë në dispozicion të tyre mjete të tjera procedurale, siç është padia e rivendikimit.

Mirëpo megjithëse pranon sa më sipër, shumica nuk i ka kushtuar vëmendje arsyetimit të mëtejshëm të Gjykatës së Lartë. Kështu, kjo gjykatë duke pasur parasysh vendimin nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër, shprehet se *"pavarësisht se në kuptimin klasik nuk jemi para gjësë së gjykuar, pasi paditësja nuk ka qenë palë në procesin e parë gjyqësor, nuk mund të injorohet fakti që jemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar një herë dhe se vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm në të gjithë harkun e pjesës së tij dispozitive."*

Kështu, me arsyetimin e mësipërm Gjykata e Lartë përjashton për kërkuesit çdo mundësi për ngritjen e padisë së rivendikimit për të cilën aludon Gjykata Kushtetuese. Kjo, për arsye se Gjykata e Lartë i ka dhënë efekte edhe për kërkuesit vendimit nr. 92, datë 9.2.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastër. Kjo gjë bën të paefektshme apo paragjykon çdo lloj padie që mund të ngrinin kërkuesit për realizimin e të drejtave të tyre. Për pasojë, shumica në vendimin e saj duhet të shprehej edhe lidhur me këtë arsyetim nëse e pranon ose jo atë dhe nëse një qëndrim i tillë cenon të drejtën e aksesit në gjykatë.

Për sa më sipër, mendoj se nuk mund të pranohet se kërkuesit kanë mjete procedurale të tjera për realizimin e të drejtës së tyre për kërkimin e trashëgimit.

Në këto kushte, mendoj se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohej dhe vendimi i Gjykatës së Lartë të shfuqizohej si jokushtetues.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Sokol Berberi[2]

[2] Gjyqtari Sokol Berberi i bashkohet mendimit të gjyqtarëve në pakicë për sa i përket pretendimeve të kërkuesve për cenim të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur përpara Gjykatës së Lartë.